



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 07

Prishtinë, më 06. 04. 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri, Nerxhivane Dauti, Hajredin Hyseni, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

Pjesëmarrës të tjerë: Rrezarta Ahmeti – KDI, Lejla Selimi – OSBE, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit, Ariton Selmanaj – KDI, Xhemajl Ahmeti - OHCHR dhe Sylë Ahmeti – Kosova sot.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ismet Beqiri, kryetar.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1 . Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23. 03. 2010,
3. Marrja e qëndrimit për procedimin e Programit të Qeverisë për barazi gjinore me kërkesë për lejimin e debati për miratimin e tij,
4. Caktimin e datës së mbajtjes të dëgjimit publik për shqyrtimin e rekomandimeve të Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve të Kosovës,
- 5 . Shqyrtimin e Peticionit të nënshkruar nga arsimtarët e Drejtorisë së Arsimit të Vitisë dhe propozimin e punëtorëve të Bufesë së Kuvendit,
- 6 . Të ndryshme.

Ismet Beqiri - Komisionit i propozoi që nga rendi i ditës të tërhiqet kërkesa për shfuqizimin e kontratës për veprën e lidhur ndërmjet punëtorëve të “Bufesë” së Kuvendit të Kosovës dhe Administratës së Kuvendit të Kosovës, për shkak të mosplotësimit të kushteve formale (mungesa e protokollit dhe të nënshkrimeve).

Rendi i ditës u miratua me propozimin e dhënë.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.03.2010

Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e 23.03.2010 .

2. Marrja e qëndrimit për procedimin e Programit të Qeverisë për barazi gjinore me kërkesë për lejimin e debati për miratimin e tij

Kryetari - Ishte i mendimit se Programi i Qeverisë për barazi gjinore para se t’i procedohet Kuvendit të Kosovës, grupi punues i caktuar nga Komisioni ta shqyrtojë serish programin dhe të nxirren rekomandimet. Pastaj nga Kryesia e Kosovës të kërkohet lejimi i debatit lidhur me Programin e Qeverisë për barazi gjinore.

Drita Maliqi – Tha se grupi punues është duke i përgatitur disa rekomandime që do t’ia paraqesin Komisionit dhe lidhur me programin propozoi që para se të procedohet për seancë plenare të mbahet një dëgjim publik.

Shpresa Murati - Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësës shtoi se grupi punues duhet t’i nxjerrë rekomandimet dhe t’i procedojë në Komision duke kërkuar përshpejtimin e procedurës lidhur me nxjerrjen e rekomandimeve.

Pas një debati konstruktiv për këtë pikë Komisioni njëzëri nxori këtë:

P e r f u n d i m

Komisioni i kërkon grupit punues të përshpejtojë me rekomandime rreth shqyrtimit të Programit për barazi gjinore dhe t’ia procedojë Komisionit për miratim.

4 . Caktimin e datës së mbajtjes të dëgjimit publik për shqyrtimin e rekomandimeve të Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve të Kosovës.

Kryetari i njoftoi anëtarët me peticionin e Shoqatës së Pavarur të Pensionistëve të Kosovës dhe lidhur me këtë pikë propozoi të mbahet një dëgjim publik.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni vendosi të mbajë dëgjim publik më 20 prill 2010, në orën 13:00, me këtë temë:
“Shqyrtimi i peticionit të Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës së Kosovës”
(SPPIPK- së .)

5. Shqyrtimin e Peticionit të nënshkruar nga arsimtarët e Drejtorisë së Arsimit të Vitisë

Nerxhivane Dauti - Në cilësi të raportueses e paraqiti mendimin për peticionin nr 03-3449-DO 2172 të datës 01. 04. 2010, të nënshkruar nga arsimtarët, nxënësit dhe prindërit e Komunës së Vitisë. Ata kërkojnë ndalimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës për marrjen e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit, që gjendet në oborrin e Qendrës së Arsimit të Mesëm.

Komisioni konstatoi se çështja e ngritur nuk bie në fushën e veprimit e tij, prandaj i rekomandon nënshkruarve të peticionit që t'i drejtohen gjykatës kompetente për kontestimin e vendimit ose ligjshmërinë e tij.

6. Të ndryshme

Kryetari i propozoi Komisionit që nga Kuvendi i Kosovës të kërkohej afat shtesë lidhur me procedimin. Arsyetimin e mbështeti në atë se ligji ka rëndësi të madhe për shoqërinë dhe kërkohej kohë për amendaminimin e tij. Gjithashtu nga kryesuesit e paneleve kërkohej ta përshpejtojnë punën e shqyrtimit të amendamenteve.

Me propozimin e kryetarit u pajtuan deputetët: Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti dhe Hajredin Hyseni.

Rrahim Demaj, koordinator i Komisionit, duke u ndërlidhur me parafolësit tha se kur të kihet parasysh rëndësia e këtij P/Ligji, si dhe amendamentet e propozuara nga subjektet e interesuara, konkretisht ekspertët nga ODIHR - i, UNDP - ja, KMDLNJ- ja dhe grupi joformal i grave, Komisionit i kërkohej afat shtesë për ta amendamentuar. Ai tha së me Nerxhivane Dautin i kemi shqyrtuar Projektligjin deri te neni 13.

Mirëpo tha se pengesa ka në nenin 27. Ky nen është problematik dhe kërkohen mjete buxhetore, si dhe të nxirret plani kryesor, në të cilin plan parashihet. Mirëpo është e paqartë se kush do të bëjë menaxhimin e këtij fondi: Ministritë, Qeveria ose Agjencia për Barazi Gjinore. Prandaj ai organ, ose trup do të formohet dhe do të ketë detyra të caktuara me trajnimin e gjyqtareve, prokuroreve dhe ekspertëve të fushave të ndryshme. Prandaj propozoi që Komisioni të caktojë një takim punë dhe të ftohen të gjitha ata që i kanë afuar këto amendamente, të shqyrtohen, inkorporohen dhe t'i procedohen Komisionit. Prandaj është e arsyeshme që të kërkohej një afat shtesë një mujor që të shqyrtohet në mënyrën e duhur.

Ibrahim Makolli - U pajtua që të kërkohej afat shtesë, ndërsa duke folur për nenin 27 të P/Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje tha se këtu ka konflikt interesi. Prandaj lidhur me këtë do të duhej të shikohen praktikat në vendet e tjera, sepse ky nen parasheh që krejt këtë proces ta udhëheqë Agjencia për Barazi Gjinore, ndërsa praktikat flasin diçka tjetër, sepse nuk kanë asgjë të përbashkët Agjencia për Barazi Gjinore me ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje. Theksoi se kjo zakonisht bëhet me krijimin e një *task-force* që e përbëjnë ministritë përgjegjëse që i përkasin kësaj fushe, kjo ngase nuk

mundet Agjencia për Barazi Gjinore t'i urdhërojë ministrit. Ishte i mendimit që të ftohet sponsorizuesi që të japë sqarim për këtë nen.

Nerxhivane Dauti - Propozoi që grupi punues të takohet më 13.04.2010, në orën 13:00, në mënyrë që të procedohet sa më shpejt.

Komisioni u pajtua që *të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit lejimi i afatit shtesë për shqyrtimin e P/Ligjit lidhur me mbrojtjen nga dhuna në familje.*

Mbledhja përfundoi në orën 14:20

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri